Plan për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore të nën-projektit:

Promovim i kushteve për zhvillim të turizmit alternativ të lokalitetit – Moçali i Monospitovës

Komuna Bosilovë, Mars 2018

Përmbajtja:

1. Përshkrim i projektit……4

2. Të dhëna themelore…….16

3. Ndikimet ndaj mjedisit jetësor……..……35

4. Masa për lehtësim…….……...39

5. Plan për menaxhimme mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore…….....……43

HYRJE

Projekti për konkurim lokal dhe rajonal(PKLR) është një operacion katërvjeçar për investim, i përkrahur nga Bashkimi Evropian i cili shfrytëzon fonde nga IPA 2 të destinuara për konkurim dhe inovacione në Maqedoni. MePKLR do të udhëhiqet si me fondin hybrid trust dhe do të përbëhet nga katër komponentë ndërsa do tëimplementohet nga Banka Botërore dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Projekti do të mundësojë mjete për investim dhe ndërtim të kapaciteteve për përkrahje të rritjes së sektorit, për investim në destinacione dhe krijim të prosperitetit në destinacione të caktuara. Në nivel rajonal dhe lokal, projekti do të përkrahë destinacione të përzgjedhura turistike në vend nëpërmjet kombinimit të ndihmës teknike për përmirësim të menaxhimit me destinacionin, për investim në infrastrukturë dhe investim në lidhshmëri dhe inovacion. Investimi do të bëhet përmes një skeme të granteve për faktorët rajonal turistik,si për shembull komunat, institucionet, OJQ-të dhe sektori privat. Ky plan për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet shoqëroreështë përgaditur për aktivitetet të cilat bëhen për projektin "Përmirësim i kushteve për zhvillim të turizmit alternativ në lokalitetin –"Moçali i Monospitovës". PKLR paraqet një dokument për mjedisin jetësor i cili përbëhet nga përshkrimi i projektit, detajet teknike, forma, mjedisi dhe vendndodhja, në bazë të së cilave vlerësohen rreziqet ndaj mjedisit jetësor dhe rreziqet shoqërore dhe masat për shmangien dhe lehtësimin e tyre.Është i domosdoshëm zbatimi i masave për lehtësim të rreziqeve të perceptuara dhe problemeve të cilat janë përmendur në PKLR.

Realizimi i këtij nënprojekti ofron mundësi për afirmim të nënprojektit në nivel ndërkombëtar.Atraktiviteti i Moçalit të Monospitovës ofron mundësi për zhvillimin e turizmit ndërkufitar me shtetet fqinje (Republika e Bullgarisë dhe Greqisë).Deri më tani, njerëz nga e gjithë Maqedonia por gjithashtu edhe nga Bullgaria dhe Greqia e kanë vizituar (dhe kanë qëndruar) në këtë lokalitet.

Nënprojekti do të ofrojë mundësi që të vendosen kontakte biznesi dhe turistike me agjencitë turistike në Republikën e Maqedonisë dhe kjo do të rrisë ofertën turistike të agjencive ekzistuese turistike dhe hotelet dhe kapacitetet për akomodim(për shkak të gjasave se turistët do të jenë më të interesuar të vizitojnë lokalitetin) si dhe mundësitë për vetëpunësim të njerëzve nga rajoni lokal nëpërmjet prodhimit të suvenirëve dhe prodhimeve tradicionale (qilima, etj.). Gjithashtu, ekziston mundësia për hapjen e „shtëpisë për mysafirët" në një stil tradicional, me mundësinë që turistët ta vizitojnë dhe të qëndrojnë aty.

Përshkrim i projektit

Qëllimi i përgjithshëm i nënprojektit është promovimi dhe përmirësimi i kushteve për zhvillim të turizmit alternativ në lokalitetin“Moçali i Monospitovës “.

Qëllimet konkrete të nënprojektit janë:

- Të vendoset në funksion dhe punë normale Qendra për turizëm alternativ dhe zhvillim kreativ në fshatin Monospitovë,
- Të tërhiqen turistë, vizitorë, ekskurzionistë, nxënës dhe studentë të cilët do të vizitojnë dhe hulumtojnëMoçalin e Monospitovës, i cili është i pasur me specie endemike(florë dhe faunë)
- Të pozicionohet lokaliteti „Moçali i Monospitovës“ në hartën turistike të Republikës së Maqedonisë,
- Të krijohen hapësira për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të larmisë biologjike të kërij lokaliteti.

Qëllimet e përgjithshme dhe konkrete do të realizohen nëpërmjet aktiviteteve të mëposhtme të projektit:

1. Pajisja e sallës së ekspozitës në **Qendrën për Turizëm Alternativ dhe Zhvillim Kreativ** në Monospitovë (nëntë rafte (polica), shtylla rrethuese metalike, shtylla prej gështenje, dërrasa, litarë për gardhin dhe tavolina prej gështenje), instalimi i ngrohjes qëndrore për Qendrën dhe ndërtimi i një vendparkiminëoborrine Qendrës;
2. Ndërtesa e Qendrës nuk është nën mbrojtjen ligjore të ndonjë institucioni kombëtar. KomunaBosilovë menaxhon dhe do të vazhdojë të menaxhojë punën e Qendrës pa u mvarurnga autoritetet shtetërore. Ndërtesa është krejtësisht e re dhe asnjë lloj aktiviteti tjetër në lidhje me të nuk është bërë (përshtatje, rindërtim, etj.).

Fotonr.1 Qendra për turizëm alterantiv dhe zhvillim kreativ

Vendosja e **shenjaverrugore dhe tabelave informuese** për hyrje në lokalitetinMoçali i Monospitovës, rindërtimi i**shtigjeve prej druri**(rreth 1.000 metra), (6) **shtëpiza prej druri** dhe (2) **vëzhgues prej druri** si dhe ndërtimi i (5) **varkave prej druri.**

Infrastruktura e drurit do të rinovohet nëpërmjet ndërrimit të të gjitha elementeve të cilat janë të papërdorshme (tabela, shtylla prej druri, mbështetëse, etj.) me qëllim që të njëjtat të jenë funksionale dhe të mos ketë rrezik që të zhvendosen. Rindërtimi do të bëhet me materiale të reja dhe disa elemente ose pjesë druri(materiali vjetër) të cilat janë të forta dhe të shëndetshme, do të përdoren sërish.
Varkat prej druri do të jenë të reja, por të ndërtuara në mënyrë tradicionale si një shfaqje e jetës tradicionale që dikur ka ekzistuar aty.
Asnjë nga materialet që do të përdoren nuk do të jetë toksik apo helmues për natyrën(sidomos për mjedisin ujor)dhe njerëzit.Rinovimi dhe rindërtimi i shtëpizave, shtigjeve dhe vëzhguesve do të mbetet në kuadër të madhësisë dhe dizajnit ekzistues.

Fotonr.2 -Shtëpizë prej druripër rindërtim

Në vendbaniminMonospitovëka një**Qendër për turizëm alternativ dhe zhvillim kreativ**.Planifikohet që e njëjta tëvihet në funksion me qëllim që të zhvillohet turizmi alternativ në lokalitetin e njohur mire "Moçali i Monospitovës".

Brendësia e hapësirave të Qendrës nuk është e përfunduar, nuk është e pajisur mjaftueshëm dhe e njëjta duhet tëvihet në fuknsion me qëllim që thesari i pasur i florës dhe faunës të mund të vizitohet, vëzhgohet, hulumtohet dhe testohet.

Është e domosdoshme pajisja e hapësirave me qëllim të formimit të një **dhome etnologjike** dhe **një dhome për ekspozita** të veshjeve tradicionale, zejtarisë, si dhe kafshëve të shpirtosuradhe specietbimore të ruajtura të cilat mund të hasen në "Moçalin e Monospitovës.

Llojet e bimëve dhe të kafshëve të cilat do të jenë të ekspozuara në Qendër do të mblidhen nga vetë moçali dhe mjedisi i afërt. **Në kuadër të këtij nënprojekti nuk do të blihen, shfrytëzohen apo mblidhen artikuj të tjerë.** Komuna Bosilovë dhe të punësuarit në Qendër planifikojnë ta pasurojnë koleksionin ekzistues në të ardhmen nëpërmjet thirrjeve të vazhdueshme për donacione nga banorët vendas (veshje tradicionale).

Tre pjesë nga tre lloje të ndryshme raftesh (polica) do të vendosen, gjithsej nëntë rafte(polica) të krijuara nga kompensatë e paprshkueshme nga uji si dhe të ngjyrosura në ngjyrë të hapur hiri; 10 pjesështylla metalike gardhi; 3 pjesështylla prej gështenje; 2 dërrasa druri; 3 rafte me imitim tëmjedisit natyror; nëntë pjesë litarë gardhi dhe 4 ulëse prej gështenje.



Foto nr.3.Vendndodhja e Moçalit të Monospitovës dhe vendbanimi Monospitovë

Foto nr.4 Rafte me imitim tëmjedisit natyror

Foto nr.5 Ulëse prej druri

Është e domosdoshme të instalohet një**sistem për ngrohje qëndrore**në Qendër me qëllim që i njëjti të funksionojë normalisht gjatë gjithë vitit. Sistemi për ngrohje qëndrore do të shfrytëzojë peleta për të ngrohur një hapësirë me sipërfaqe prej 265 m^2.

Është e domosdoshme të ndërtohet **vendparkim** menjëherë pranë Qendrës, në mënyrë që vizitorët dhe turistët të mund të kenë qasje, ta vëzhgojnë dhe vizitojnëQendrën për turizëm alternativ dhe zhvillim kreativ, ose ta hulumtojnë Moçalin e Monospitovës. Vendparkimi ekzistues zë një hapësirë prej 140 m2 dhe kjo do të jetë tërësisht e mjaftueshme për tu parkuar rreth 10 automjete udhëtarësh, mini furgonë dhe minibusë. Nuk është parashikuar të ketë ndriçim special për shkak se ndriçimi rrugor është i mjaftueshëm për vendparkimin që të jetë i ndriçuar.Vendparkimi do të ngelë në madhësinë e njëjtë, dhe nuk do të financohet asnjë lloj zgjerimi tjetër.

Vendparkimi është pjesë përbërëse e Qendrës, ashtuqë i njëjti nuk do të përdoret si vendparkim publik. Vendparkimi do të përdoret vetëm për automjetet e turistëve dhe vizitorëve të Qendrës – që do të thotë se qëllimi i tij do të jetë i përcaktuar në mënyrë rigoroze në përputhje me Qendrën për turizëm alternativ dhe zhvillim kreativ..

Foto nr.6 Vendparkimi

Është i domosdoshëm montimii **shenjaverrugoredhe tabelave informuese**(3 copë) për lokacionin e Moçalit të Monospitovës si pjesë e aaritjes nëtë, me qëllim që i njëjti të jetë lehtësisht i dallueshëm dhe në dispozicion.

Në kuadër të nënprojektit,gjithashtu parashihet **rindërtimii shtigjeve prej druri, shtëpizave prej druri dhe vëzhguesve prej druri** të cilët shërbejnë për vëzhgim dhe hulumtim të rrethinës së Moçalit të Monospitovës.

Ka rrugë hyrëse deri te lokaliteti qëështërrugë fuknsionale dhe tërësisht e mjaftueshme për qasje deri te punëtorët të cilët do të punojnë në vendngjarje. Nuk do të ketë kamp për punëtorët. Vendi i lokacionit nuk do të jetëobjekt i aktiviteteve punuese të planifikuara, prandaj nuk parashikohet pastrim i vendit në kuadër të këtij nënprojekti. .

Gjatësia e përgjithshme e shtigjeve prej druri të cilat duhet të ndërtohen është 1.000 metra.Dy vëzhgues duhet të rindërtohen.Shtatë shtëpiza prej druri gjithashtu duhet të rindërtohen dhe ato zënënjë hapësirë prej gjithsej 26 m2 (hapësira e të gjitha shtëpizave).

Kjo infrastrukturë druri veç më ekziston dhe e njëjta vetëm do të rinovohet me materiale të reja (dru tëri). Ku është e nevojshme, shtyllat mbështetëse do të rinovohen (zavendësohen), në mënyrë që ndërtimi të jetë stabil. Druri i ri që do të përdoret për rindërtim të shtigjeve ekzistuese, vëzhguesve dhe shtëpizave, do të përdoret në gjendjen e tij natyrale dhe i njëjti nuk do të trajtohet me mjete mbrojtëse për dru, ngjyra, shtresa, llaqe ose agjentë të tjerë në ç'farëdo mënyre tjetër përveç përpunimit mekanik (prerje në dimensionet e nevojshme). Trajtimi mekanik

i materialit të drurit do të bëhet në punëtoritë e furnizuesit me materiale prej druri të përzgjedhur me anë të procedurës për furnizime publike. Druri me dimensionet të cilat janë të nevojshme në përputhje me detajet teknike të dizajnit, do të dorëzohet në vendin e ndërtimit dhe me dorë do të montohet tek shtigjet, shtëpizat dhe vëzhguesit. Nuk do të përdoren ngjyra apo llaqe si materiale mbrojtëse me qëllim që të ruhet autenticiteti i strukturave ekzistuese.

Druri që do të përdoret do të jetë natyral pa asnjë lloj mbrojtjete kimike ose ç'farëdo lloj tjetër mbrojtjeje. Në atë mënyrë, do të përshtatet në ambientin natyror të lokalitetit.

Për vëzhgim më të thellë, do të ndërtohen pesë **varka prej druri. Varkat prej druri** do të mundësojnë depërtim dhe vëzhgimnë brendësinëe moçalit.

Ato do të bëhen prej materiali prej druri në mënyrë që ti përgjigjen ambientit natyror.

Varkat prej druri do të krijohen tërësisht në punëtori në distancë prej disa kilometrash prej moçalit. Gjithashtu, në to nuk do të përdoret asnjë lloj ngjyre, shtrese, mbrojtje të drurit, llaku, apo agjentë të tjerë.

Materialet prej druri do të jenë natyrore pa asnjë lloj materiali shtesë, mbrojtjeje me mjete kimike, etj. Nuk do të përdoren kemikale për mbrojtjen e tyre.

Fotonr.7 Varkë prej drurinë Moçalin e Monospitovës

Të gjitha këto parakushte janë të nevojshme qësamë shumë njerëz të mund të vizitojnë lokalitetin dhe të krijohen më shumë mundësi për zhvillim të turizmit rural dhe kulturor. Lokacioni konkret i nënprojektit:

- fsh. Monospitovë (KomunaBosilovë)
- Rrethina e fsh.Monospitovë (lokaliteti Moçali i Monospitovës)

Destinacioni i përfshirë:

- Destinacioni nr.9: Strumica dhe rrethina e saj

Rezultatet e pritura:

a) Qendër e pajisur, fuknsionale dhe moderne për turizëm alternativ dhe zhvillim kreativ.

b) Ndërtimi i vendparkimit bashkëkohor dhe funksional.

c) Vendosja e shenjave rrugore dhe sinjalistikës informuese.

ç) Rindërtimi i infrastrukturës së drurit në këtë lokalitet(shtigje, shtëpiza, vëzhgues)

d) ndërtimi i varkave tradicionale prej druri për lundrim të brendshëm në liqenet e moçalit.

Realizimi i projektit do të ketë ndikim pozitiv në destinacion (Strumica dhe rrethina e saj) dhe do të krijojë mundësi të pazakonta për rritjen e atraktivitetit të bukurisë natyrore të këtij destinacioni. Në kontekst me ujëvarat e Smolarës dhe Kolesinës, burimet e Mokrievit, të cilat gjenden në vetëm disa kilometra larg Moçalit të Monospitovës, harta turistike e destinacionit do të pasurohet me një lokalitet tjetër i cili ofron larmi sa i përket bukurive natyrore të destinacionit. Nën-projekti ofron mundësi për punë shkencore dhe hulumtuese rreth florës dhe faunës së pasur në këtë vend, për shkak se ato nuk janë testuar dhe hulumtuar mjaftueshëm.

Gjithashtu, banja e nxehtë ekzistuese (spa) në Bansko (rrëzë malit Bellasicë), ecilaështë atraktive për shërim dhe rekreacion dhe e cilaështë vetëm disa qindra metra larg lokalitetit, do të mundësojë që turistët të cilët qëndrojnë aty mos ta anashkalojnë Moçalin e Monospitovës.

Lidhjet e mira të komunikacionit për këtë destinacion mundësojnë qasje të lehtë dhe të shpejtë deri te lokacionet e sipërpërmendura.

Nënprojekti akoma më shumë do ta rrisë tendencën e lokalitetit drejt zhvillimit të turizmit rural në këtë destinacion, i cili gjithahstu do të marrë edhe një impuls të fortë me realizimin e këtij nënprojekti.

Numri i rritur i turistëve do të mundësojë më shumë punë për ndërmarrjet e vogla tregtare të vendosura në rrethinën e afërt te objektit. Është e sigurtë se nënprojekti do të mundësojë që numri i turistëve të rritet, për shkak të interesit tëzmadhuar për këtë lokalitet. Numri përfundimtar nëlidhjeme atë se sa njerëz e kanë vizituar këtëlokalitetështë shumë modest dhe pothuajse rreth 1000 njerëz në vit. Por, me realizimin e të gjitha aktiviteteve të nënprojektit, besojmë se ky numër do të rritet në disa mijëra njerëz në vit (turistë). Hotele dhe restorane të caktuara shfaqin interesim që të ofrojnë akomodim dhe ushqim për turistët. Ngarkesa e shtuar e punës do të rezultojë në rritje të nevojës për kuzhinierë dhe kamarierë, udhëheqësve turistikë nëpër lokalitetin natyror dhe liqenet e voglatë Moçalit.

Për shkak të faktit se ekziston një numër i kapaciteteve akomoduese në rrethinën e lokalitetit (nëStrumicë, Bansko, Podgorski An dhe pjesët e ngelura të këtij destinacioni), ne besojmë se nënprojekti do ta rrisë numrin e turistëve të cilët do të kalojnë natën aty.

Pika e fillimit e cila gjatë viteve do të rritet, do të jetë rreth një mijë qëndrime brenda natës. Sektori privat sheh mundësi në promovimin e këtij nënprojekti në drejtim të zhvillimit të turizmit rural (fshatar) nëpërmjet krijimit të objekteve hotelierike dhe objekteve të vogla akomoduese.

Nënprojekti ofron mundësi të pazakonta për vetëpunësim dhe angazhim gjatë gjithë vitit.

Qendra për turizëm alternativ dhe zhvillim kreativ do të ofrojë informacione dhe do të ndihmojë në çfarëdo lloj ideje në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës.

KORNIZA LIGJORE

Procedura për vlerësim kombëtar të ndikimit ndaj mjedisit jetësor për zhvillim të projektit

Procedura për vlerësimtëndikimit ndajmjedisit jetësor është e paraparë në Ligjin për mjedisin jetësor, Gazeta Zyrtare nr. 53/05, 81/05 24/07, 159/08 и 83/09; 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 163/13, 42/14, 129/15 dhe 39/16 (Kreu 11/Neni 76-94) ku janë transpozuar kërkesat e direktivave të BE-së për EIA (Direktiva 85/337/EEC në përputhje me ndryshimet e direktivavetë 97/11/EC, 2003/35/EC и 2009/31/EC).

Procedura fillon kur investitori(propozuesi i projektit) i cili ka për qëllim ta zbatojë projektin, dorëzon Letër qëllimi në formë të shkruar dhe elektronike deri te Ministria emjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor (MMJPH – Drejtoria për mjedisin jetësor), i cili është edhe organi përgjegjës për të gjithë procedurën. Drejtoria për mjedisin jetësor është e obliguar që të japë përgjigje në kërkesën konkrete nëse është e nevojshme ose jo që të zhvillohet VSMJ (vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor), VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) ose elaborate për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Procedura për skrining (screening) është fazë në të cilën MMJPHvendos nëse duhet të krijohet VSMJ (vlerësimi strategjik i mjedisit jetësor), VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) ose elaborat.

Për zhvillimin e projekteve të cilat nuk përkasin në listën e projekteve për të cilat duhet patjetër të zbatohet procedura VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor)**(projekte të vogla)**, është e nevojshme të përgaditet „Elaborat-Raport për ndikimin ndaj mjedisit jetësor“**(relevante për projekte të kategorisë B sipas SB OP 4.0.1 procedura për Vlerësim tëmjedisit jetësor)**.

Procedura kombëtare për vlerësim tëmjedisit jetësor për projekte të vogla

Gjatë kohës së procedurës kombëtareVNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) gjatëperiudhës së fazës “screening”, nëse nga ana e Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor merret vendim që nuk ka nevojë për zbatim të procedurës VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor), investitori duhet të fillojë me procedurën për zhvillim të**Elaboratit-Raport për ndikimin ndaj mjedisit jetësor**. Kjo procedurëështë e obligueshme për projekte të vogla të cilat shkaktojnë ndikime afatshkurtra, të vogla dhe negative ndaj mjedisitjetësor kur Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor në kuadër të vendimit të sipërpërmendur ka deklaruar se nevoja për përgaditje të Elaboratit është në përputhje me rregulloret e mëposhtme (psh. Rindërtimi ose ndërtimi i rrugëve lokale, rrugicave, ndërtimi i rrjeteve lokale të ujësjellësit, kanalizime dheWWTP- (waste water treatment plant – impiant për trajtimin e ujërave të zeza) me vëllim të vogël – më të vogël se10 000 r.e., etj.).

Ka dy Rregullore për sa i përket projekteve për të cilat duhet të përgaditet Elaborat -Raport VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor):

A) Rregullore për listën e projekteve për të cilat duhet të përgaditet Elaborat -Raport VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) nga ana e investitoritdheRaporti VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) duhet të jetë i pranuar nga ana e Ministrisësë mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor(GazetazyrtareeRM-së nr. 36/12);

B) Rregullore për listën e projekteve për të cilat duhet të përgaditet Elaborat -Raport VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) nga ana e investitoritdheRaporti VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) duhet të jetë i pranuar nga ana ekryetarit të komunës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 32/12) osekryetari i qytetit të Shkupit.

C) Përmbajtja e Elaboratit-Raportit VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) duhet të jetë nëpërputhje me rregulloren për formën dhe përmbajtjen e Raportit VNMJ(vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) dhe procedurën për pranim të Raportit VNMJ(vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 123/12).

D) Elaborati -Raporti VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) përmban karakteristikat kryesore të aktiviteteve projektuese, ndikimet kryesore negative dhe pozitive ndaj mjedisit jetësor të cilat janë të perceptuara gjatë marrjes parasysh tëtë dhënave bazë për mjedisin jetësor të cilat janë specifike për lokalitetin konkret. Programi shumë i thjeshtëzuar për mbrojtjen e mjedisit jetësor përbëhet nga masa të llojllojshme të cilat do ta ndalojnë, lehtësojnë dhe kompenzojnë ndikimin negativ ndaj të gjitha elementeve tëmjedisit jetësor në bazë të legjislacionit kombëtar për mjedisin jetësor dhe praktikën e mirë ndërkombëtare. Nuk parashikohet debat publik për përgaditjen dhe pranimin e Elaboratit-Raportit VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) (nëpërputhje me legjislacionin kombëtar). Në fotografinë nr.1 është paraqitur një skemë më e thjeshtëzuar e procedurës për Elaboratin-Raportin VNMJ (vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) si dhe organi kompetent për pranim të Elaboratit-Raportit.



Foto 1 - VNMJ (Vlerësim i ndikimit ndaj mjedisit jetësor) kërkesat kombëtare për projekte me vëllim të vogël

Për arsye se aktivitetet e nënprojektit nuk janë pjesë e dispozitave ligjore të legjislativës kombëtare dhe akteve nënligjore (rregulla, dekretedhe rregullore) për realizimin e aktiviteteve të parapara për nënprojektin„Përmirësimikushteve për zhvillim të turizmit alternativ në lokalitetin Moçali i Monospitovës“nukështë e nevojshme të përgaditet dokument i caktuar ose të zbatohet ndonjë procedurë konkrete për ndikimin e këtij projekti ndaj mjedisit jetësor. Për më tepër, kjo vërtetohet me përgjigjen e Letrës së Qëllimit nga ana e Komunës Bosilovë deri te Ministria emjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.

Përkrahja e marrë dhe mendimi pozitiv profesional nga ana e Ministrisësëmjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor/Drejtoria për mjedisin jetësor (pjesë nga dokumentacioni i dorëzuar), flet në favor të asaj që u tha më lart.

Si shtojcë e këtij Plani për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore (në fund të këtij dokumenti) është vendosur mendimi profesional i Ministrisësëmjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor.

Mendimi profesional i Ministrisësëmjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor së RM-së do të thotë se nuk është e nevojshme të bëhet elaborat ose dokument tjetër për mbrojtje tëmjedisit

jetësor. Ministria e përkrah projektin dhe realizimin e tij dhe nuk pretendon se është e domosdoshme të përgaditet dokument i caktuar për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Mendimi profesional është pozitë zyrtare, mendim zyrtar dhe vendim zyrtar i Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor të Republikës së Maqedonisë.

Konsultime publike rreth Planit për menaxhim me mjedisin jetësor për projektin

Plani i përgaditur për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore (PMMJ) për këtë projekt do të jetë pjesë e dokumentacionit tëtenderit dhe marrëveshjes me kontraktuesin (bashkë me llogaritjen e premisave) të cilat do të jenë të obligueshme për zbatimin e masave të parapara në përputhje me Planin për lehtësim dhe monitorim. Zbatimi i PMMJ-së është i obligueshëm për kontraktuesin.

Inxhinieri-mbikqyrësi, i angazhuar nga komuna, ka për detyrë të mbikqyr dhe vlerësojëzbatimin e masave tëpropozuara në kuadër të planit për mbikqyrje dhe ta njoftojë investitorin dhe zyrën për projektin **PKLR (Projekt për konkurim lokal dhe rajonal)/**Komunën Bosilovë. Komuna do të njoftojë rreth gjendjes sëmjedisit jetësor dhe zbatimin e masave për lehtësim dhe mbikqyrje në raportet e rregullta për progresin e nënprojektit dhe në Raportin e veçantë për zbatim të PMMJ-së në çdo tre muaj (nëse nuk caktohet ndryshe nga ana e ekspertit për mjedisin jetësor, miratuar nga specialist për mjedisin jetësor nga SB) deri te ekspertipër mjedisin jetësor.

Në përputhje me KMMJ– (Korniza për menaxhim me mjedisin jetësor), kyPMMJ duhet që patjetër të kalojë në konsultim publik para se të zgjidhet përfundimisht nën-granti.Sapo draft verzioni i PMMJ-së të miratohet nga Njësiti për zbatim të projektit – NJZP, eksperti për mjedisin jetësor dhe specialisti për mjedisin jetsor nga SB, i njëjti do të shpallet në faqen e internetit të (Njësitit për zbatim të projektit – NJZP) (Kabineti i zëvendës shefit të Qeverisë së RM-së për çështje ekonomike), Agjencioni për promovim dhe përkrahje të turizmit si dhe faqen e internetit të komunës në fjalë (Komuna Bosilovë) ku do të qëndrojë në dispozicion për publikun të paktën 14 ditë. Një shembull në formë të shtypur do të jetë në dispozicion në Njësitin për zbatim të projektit – NJZP (KZSHQRM –Kabineti i zëvendës shefit të Qeverisë së RM-së për çështje ekonomike) dhe Komuna Bosilovë. Thirrja për komentim dhe pjesëmarrje në takimin për konsultim publik(bashkë me kohën dhe vendin) do të shkojë bashkë me PMAJ-në. Takimi për konsultim publik do të mbahet në komunën përkatëse kah fundi i përiudhës për konsultime. Në mënyrë proaktive, aplikuesi (Komuna Bosilovë) do t'i informojë dhe ftojë faktorët e mëdhenjë, përfshirë këtu edhe OJQ-të lokale, bashkësitë dhe komunat e interesuara, drejtëpërdrejtë dhe në mënyrë adekuate. Komentet e bëra do të përfshihen në Raportin për dëgjesën publike, e që do të jetë pjesë e verzionit përfundimtar të PMMJ-së. Në atë mënyrë, të gjitha komentet e publikut do të jenë në dispozicion të aplikuesit dhe ato do t'i ndermarrintë gjitha komentet relevante dhe do t'i përfshijnë përgjigjet dhe vërejtjet në PMMJ-në përfundimtar.

PMMJ duhet patjetër të kalojë në konsultim publik në gjuhën angleze, maqedone dhe shqipe.Zbatimi i Planit për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore do të bëjë të mundur në kohë reale ndërmarrjen e masave të propozuara dhe do të kontribuojë në realizimin e aktiviteteve projektuese pa ndikime domethënëse ndaj mjedisit jetësor.

Të dhëna bazë

2.1. Përshkrim i komunës

Aktivitetetnë lidhje me zbatimin e nënprojektit „Përmirësimi i kushteve për zhvillim të turizmit alternativ në lokalitetin – Moçali i Monospitovës“ do të bëhen në territorin e komunës Bosilovë.

Komuna Bosilovë është njësi e vetëqeverisjes lokale e cila kryen punët e saj në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje. Komuna është një qendër shërbimi për qytetarët në fushën e problemeve komunale, ndërtimit, detyrimeve tatimore, arsimit, mbrojtjes së mjedisit, kulturës, sportit, etj.

Me administratën e saj, si dhe me ndërmarrjen e saj komunale "Ograzhden", komuna po përpiqet të plotësojë nevojat e ndryshme të popullsisë lokale.

Në këtë komunëështë edhe ndërmarrja komunale – „Ograzhden“ - Bosilovë. Detyrat kryesore të kësaj ndërmarrjeje janë organizimi i furnizimit me ujë në vendbanime, mirëmbajtja e higjienës komunale, mirëmbajtja dhe rindërtimi i ndriçimit rrugor, si dhe mirëmbajtja e kanalizimit të hapur atmosferik.

Komuna e Bosilovës ka kapacitetin për të menaxhuar mjedisin jetësor në territorin e saj nëpërmjet një departamenti të organizuar posaçërisht për shërbimet komunale, si dhe nëpërmjet një inspektori të autorizuar mjedisor.

Komuna e Bosilovës është njësi vetëqeverisëse me selinë zyrtare në vendbanimin e Bosilovës.

Autoritetet komunale janë kryetari i komunës, i cili përfaqëson komunën dhe Këshilli komunal, i cili përbëhet nga 15 këshilltarë si organ për përfaqësimin e banorëve në komunë. Për të kryer aktivitete që janë në kompetencë të organeve komunale dhe qëjanë në përputhje me Aktin e Sistematizimit, administrata komunale përbëhet nga tri departamente:

-departamenti për aktivitete ligjore, të përgjithshme dhe publike,

-departamenti për buxhet, financadhe kontabilitet,

- departamenti për punë komunale dhe zhvillim ekonomik lokal, i cili përbëhet nga një inspektor i autorizuar mjedisor, i cili kryen detyrimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, inspektori komunal dhe radari komunal

-departamenti për punë inspektuese – inspektorati (për arsim, për tatime, për ndërtim, për trafik).

Territori i komunës së Bosilovës për punët në lidhje me mjedisin, në nivel kombëtar, mbulohet nga inspektor shtetëror i mjedisit, i cili kryen detyrën e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar. Administrata komunale ka gjithsej 17 punonjës dhe për këtë arsye krijimi i sektorëve nuk është kryer në mënyrë organizative.

Në përputhje me legjislacionit kombëtar të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e projekteve në zona të mbrojtura, komuna Bosilovëmori**mendim pozitiv të ekspertëve** nga Ministria e Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë dhe mbështetjen për këtë projekt bazuar në një shqyrtim të tëgjithë dokumentacionit që u ishte dorëzuar atyre. Të gjitha aktivitetet e projektit në përputhjemeautoritetin kombëtar mjedisor nuk do të prishin larminë biologjike të lokacionit. I njëjti mendim profesional është pjesë përbërëse dhe plotësuese e dokumentacionit të projektit.

I vetmi organ qeverisës përgjegjës për gjendjen, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Moçalit të Monospitovës është Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë. Asnjë autoritet tjetër shtetëror apo lokal nuk ka të drejtë të marrë vendime, mendime të ekspertëve, konkluzione etj. në lidhje me këtë lokacion. Kur do të jetë i mbrojtur si monument natyror në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Moçali i Monospitovës do të menaxhohet nga ana e një organitë autorizuar në përputhje meaktinpër deklarim tëMoçalit të Monospitovës si një monument natyror.

Mendimi i ekspertëve është një akt tepër i mjaftueshëm për marrjen e mbështetjes dhe lejes për të kryer aktivitetet e parapara të projektit.

Sa i përket natyrës së aktiviteteve të projektit dhe ndikimit të tyre të parëndësishëm ndaj mjedisit jetësor, dhe duke patur parasysh atë se ato janënë përputhje me legjislacionin kombëtar - nuk nevojiten leje të posaçme për përmbushjen e tyre. Të gjitha aktivitetet e infrastrukturës do të kryhen në përputhje me programin e projektit, të cilin kontraktuesi duhet ta monitorojë dhe zbatojë.

Me Ligjin për ndarje territoriale në Republikën e Maqedonisë (Gazeta zyrtare e RM-së nr.49/96) është formuar Komuna e Bosilovës, me gjithsej 15 vendbanime. Në vitin 2004, me organizimin e ri territorial, komuna vazhdon të ekzistojë, por tashmë edhe me një vendbanim tjetër në përbërjen e saj (gjithsej 16 vendbanime) dhe atë: Bosilovë, Turnovë, Radovë, Ilovicë, Shtukë, Sekirnik, Borievë, Monospitovë, Robovë, Ednokuqevë, Petralinc, Saraj, Geçerlija, Drvosh, Hamzalija, dhe Staro Baldovc.

Komuna Bosilovë ka historinë e saj si një komunë e vjetër, e cila edhe më herët ka ekzistuar përkatësisht që nga viti 1952 e deri në vitin 1963 kur u shfuqizuan komunat rurale. Për shkak se formimi i saj i pare është bërë më 10 Prill të vitit 1952, kjo datë festohet si Dita (Festa) e Komunës.

Fotonr.9 Ndërtesa e komunës së Bosilovës

2.2. Karakteristika gjeografike

Territori i Komunës së Bosilovës shtrihet në juglindje të Republikës së Maqedonisë dhe një pjesë e saj zë pjesën qendrore të Fushës së Strumicës, ndërsa me pjesën tjetër ngrihet në vijën e malit Ograzhden. Komuna e Bosilovës shtrihet në një sipërfaqe prej 150 km2 dhe gjendet në një lartësi mbidetare prej 250 metrash. Ajo kufizohet me komunat fqinje: Berovë, Strumicë, Vasilevë dhe Novo Sellë.

Komuna ka një pozitë të mirë gjeografike. Është e vendosur vetëm 7 km nga qendra më e madhe urbane në rajon, qyteti i Strumicës, me të cilin lidhet nëpërmjet rrugës magjistrale A-4, e cila në të njëjtën kohë lidh Komunën edhe me pikën kufitare me Republikën e Bullgarisë.

Nëpërmjet Komunës, çon edhe rruga rajonale deri në Berovë, e cila kalon nëpër malet Ograzhden dhe ato të Maleshevës, përmes të cilave rrumbullakoset magjistralja lindore.

Fotonr.11 Harta e komunës së Bosilovës

2.3 Përbërja gjeologjike dhe relievike

Komuna Bosilovë ka strukturë relievike kontraste, e përbërë prej një fushe pjellore dhe zonave kodrinore-malore. Nga të gjitha vendbanimet në komunë, 12 prej tyre janë vendbanime rrafshinore, ndërsa 4 janë kodrinore.

Rajoni i Komunës ndahet në zona kodrinore-malore, në të cilat përfaqësohen tokat e shkallëzuara dhe ultësirat, tokat aluviale, rrëshinoret, dhe tokat gëlqerore.Shumica e zonave të kultivuara i përkasin pjesës relievike tërrafshët, dhe gjenden në një lartësi mbidetare prej 250 metrash dhe janë të një rëndësie të shkallës së parë për bujqësinë në këtë Komunë.Këto janë hapësirat pranë shtratit të lumit Strumicë dhe Turija.Pjesa tjetër e zonave bëjnë pjesë në pjesën relievike kodrinore-malore.Kjo karakteristikë bonitente dhe e tokës e kësaj komune përcakton edhe mënyrën e përdorimit të tokës nga entet bujqësore, ashtuqë nga zona e përgjithshme bujqësore, pjesa më e madhe (87%) i përket zonave të kultivuara ku dominojnë tokat bujqësore dhe kopshtet.

2.4. Karakteristika hidrologjike

Rrjeti hidrografik në komunën e Bosilovës është mjaft i ndërthurur me një numër lumenjsh,

përrenjsh, rezervuare artificiale, etj. Përfituesi kryesor në Komunë, me një shtrat të rregullt, është lumi Strumicë, i cili në komunë shtrihet në gjatësi prej 9.5 km. Derdhja e majtë e lumit Strumicë është lumi Turija, me një gjatësi të shtratit në komunë prej 7 km. Derdhja e djathtë e lumit Strumicë është kanali i Monospitovës me shtrat prej14 km, i cili është i rregulluar në gjatësi deri te Moçali i Monospitovës. Në lumen Turija rrjedh një kanal lumor më i vogël - Petraliçki Azmak dhe Lumi Iloviçka, në një gjatësi prej 9.8 km, i cili rrjedh nga diga, përkatësisht nga rezervuari artificial i Ilovicës. Në lumin Strumicë, derdhet edhe lumi Shtuçka i cili buron nga shpatet e malit Ograzhden, me një gjatësi të shtratit prej 4 km.

Asnjë aktivitet i projektit nuk do të kryhet në lumin Vodoçnicë dhe në Moçalin e Monospitovës. Realizimi i aktiviteteve të projektit nuk do të ndikojë në cilësinë dhe sasinë e ujërave në territorin e komunës së Bosilovës.

2.5. Klima

Për shkak të pozicionit specific gjeografik, komuna e Bosilovës karakterizohet nga dy klima zonale. Klima nën-mesdhetare, me gërshetim më të madh ose më të vogël me klimën kontinentale lindore, ndërlidhja e të cilave rajonit i jep njëetiketim të veçantë - verëra të ngrohta të gjata me temperatura të larta mesatare ditore dhe një sasi vjetore shiu të reduktuar, temperatura më të ulëta të dimrit dhe shfaqje të erërave nga të gjitha drejtimet.

Karakteristike për komunën e Bosilovës janë erërat veri-perëndimore dhe jugperëndimore, ndërsa më të rralla janë erërat e veriut dhe ato të ngrohta të jugut.

Sa i përket nxehtësisë së diellit, komuna karakterizohet nga një periudhë e gjatë me ditë me diell gjatë vitit dhe me intensitet të lartë drite (ka rreth 230 ditë me diell gjatë vitit). Shkëlqimi i diellit mesatarisht zgjat rreth 2,377 orë në vit. Mjegullat mesatarisht kanë një maksimum prej 20 ditësh në vit.

Për shkak të ndikimeve nën-mesdhetare dhe ndikimit të klimës kontinentale, kushtet klimatike në komunë karakterizohen nga një sasi e reduktuar e shirave dhe një temperaturë dimërore e reduktuar. Temperatura ditore në periudhën e dimrit ulet deri poshtë shkallës së tretë të Celsiusit, ndërsa në periudhën verore arrin edhe deri mbi 40oC. Sa i përket rreshjeve të shiut në nivel vjetor, ato variojnë nga 330 mm^3 për m^2 në 884 mm^3 për m^2.

2.6 Burime natyrore

Sipas pasurisë me burime natyrore, gjetje metalike në komunë ende nuk janë të njohura, por megjithatë sërish ekziston një minierë për jo-metale.Miniera për eksploatim të fishekëve – Ograzhden, është e karakterit të natriumit dhe është e vetmja në Republikën e Maqedonisë, por

edhe në Ballkan.

Trupat minerale petrografike të albitit karakterizohen nga ngjyra e bardhë, teksturë masive dhe strukturë të ndryshueshme. Në lidhje me përmbajtjen mineralogjike, ato përmbajnë 89-94% albite, 4-8% kuarc, 0.5% sericite, si dhe mbetjet e vogla në rutile, titan dhe alkrital.

Është konfirmuar depozitë e bakrit dhe arit në Malin e Ograzhdenit në afërsitëvendbanimeve Ilovica dhe Shtuka. Pritet që shfrytëzimi i kësajpasurie xeherore të fillojë në vitin 2017. Depozitai është dhënë me koncesion kompanisë "Euromax Resources", e cila gjithashtu ka edhe licencë për shfrytëzim.

Burime të tjera të rëndësishme natyrore në Komunë janë pyjet që përfaqësohen në një sipërfaqe prej 4,996 hektarësh dhe tokat që përfaqësohen në sipërfaqe prej 2,086 hektarësh.Ato në masë të madhe mundësojnë zhvillimin e bagëtisë.

Një burim natyror interesant në komunë është gjithashtu Moçali i njohur i Monospitovës i cili ndodhet në afërsi të vendbanimit Monospitovë. Ka një pasuri me bollëk sa i përket bimëve dhe kafshëve, duke bërë të mundur kështu realizimin e një numri të madh projektesh në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të eko-turizmit.

Foto nr.13 Minierë për jo-metale në malin Ograzhden

2.7. Popullsia

Sipas të dhënave statistikore të vitit 2002, komuna e Bosilovës numëron 14,260 banorë në 16 vendbanime dhe një numër të përgjithshëm të familjeve prej 3,661. Numri mesatar i anëtarëve në një familje është 3.90, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë së komunës është 88 banorë për

km2.

Sipas përbërjes kombëtare të popullsisë në komunë, shumica e tyre janë maqedonas (13.649), turq (495), romë (24), serbë (8) dhe pjesa tjetër (84).

Sipas aktivitetit ekonomik në Komunë, gjithsej aktiv janë 6,259 banorë, prej të cilëve 4,336 janë të punësuar dhe 1,923 janë të papunë. Në grupin ekonomikisht joaktiv, janë regjistruar 4,912 banorë.Bazuar në këto të dhëna, mund të arrijmë në përfundim se shkalla e papunësisë në komunën e Bosilovës është 32% dhe shkalla e punësimit është 69%.

Tabela nr.1: Popullsia në komunën Bosilovë – Regjistrimi i vitit 2002

Nr.rendor	**Vendbanimi**	**Numri i banorëve**	**Numri i familjeve**
1.	Borievë	926	278
2.	Bosilovë	1698	446
3.	Geçerli	373	88
4.	Drvosh	699	163
5.	Ednokuqevë	678	165
6.	Ilovicë	1907	464
7.	Petralincë	605	174
8.	Radovë	851	200
9.	Robovë	576	149
10.	Saraj	937	245
11.	Sekirnik	1194	315
12.	Staro Baldovcë	269	71
13.	Turnovë	941	242
14.	Hamzali	22	7
15.	Shtukë	781	207
16.	Monospitovë	1803	447

	Gjithsej:	**14,260**	**3,661**

Burimi: Instituti shtetëror i statistikës në Republikën e Maqedonisë

Shikuar në aspektin e punësimit sipas sektoreve, përqindja më e madhe e popullsisë (70,7%) merret me bujqësi, industria përfaqësohet me 12,6%, ndërsa aktivitetet e shërbimit me 16,7%.

2.8. Larmia biologjike, habitati natyror i ujit- Moçali i Monospitovës

Në territorin e Komunës së Bosilovës ekziston njëraritet natyror në sipërfaqe prej 400 ha, me elemente të vlefshme floristike të një rëndësie të jashtëzakonshme shkencore – Moçali i Monospitovës.

Ndonëse Moçali nuk është shpallur akoma monument natyror, deri më sot nuk janë krijuar masa të domosdoshmepër mbrojtje si: përcaktimi i një organizate që do ta menaxhojë atë, përpilimii një plani menaxhimi dhe mbështetjeje financiare nga shteti. Moçali i Monospitovës si një lokalitet me interes kombëtar, përmendet në Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtjen e larmisë biologjike të Republikës së Maqedonisë (Ministria e Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, 2004). Kjo strategji kombëtare parashikon rivitalizimin e Moçalit të Monospitovës si pjesë e sistemit të zonave të mbrojtura, inkurajim për përdorimin tradicional të larmisë biologjike dhe ekoturizmit, kryerjen e projekteve kërkimore, etj.

Në Planin Hapësinor të Republikës së Maqedonisë (me vlefshmëri deri në vitin 2020) Moçali i Monospitovështë futur në sistemin e zonave të mbrojtura. Janë duke u zhvilluar aktivitetet e Ministrisë së Mjedisit jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë për miratimin e Ligjit për shpalljen e zonës së Moçalit të Monospitovës si zonë e mbrojtur në kategorinë e monumentevenatyrore.

Sipas legjislacionit më të ri në Republikën e Maqedonisë, Moçali i Monospitovës nuk është shpallur zyrtarisht monument natyror. Legjislacioni ekzistues është krejtësisht ndryshe dhe sipas përmbajtjes poashtu ndryshe nga rregullorja e para 30 viteve kur ky vend është shpallur monument natyror me vendim (akt të zakonshëm) të Këshillit të Komunës së Strumicës.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës ka kushte të tjera që duhet t'i plotësojë një lokalitet me qëllim që tëmirret statusi i monumentit natyror (përgatitja e studimit të rivlerësimit të larmisë biologjike, e planitpër menaxhim të zonës së mbrojtur dhe në fund sjellja e një Ligji për shpalljen e Moçalit të Monospitovës si Monument Natyror nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë). Si rrjedhojë,ky vend nuk ka marrë ende zyrtarisht një status të tillë.

Lartësia mesatare mbidetare e Moçalit të Monospitovës është rreth 210 metra mbi nivelin

e detit, me pikën më të ulët 202 metra mbi nivelin e detit dhe më e larta në 240 metra mbi nivelin e detit.

Foto nr.15 Baza e planifikimit të Moçalit të Monospitovës

Legjenda:

Bimët e moçalit	
Bimë lule	
Bimë pyjore	
Barishte	
Vendbanim	
Qendër informimi	
Qumështore	
Sera	
Këndvështrime	
Shteg për vëzhgim	
Liqene të vogla	
Fusha	

Brez kallami dhe shqire	
Pyje	
Livadh me lagështi	
Rrugë	
Lum	
Kanal	
Përfshirja e hapësirës	





Foto nr.17 Harta e Moçalit të Monospitovës

Si tipar kryesor i i Moçalit të Monospitovës padiskutim është lar miae jashtëzakonshme bimore.Këtu gjenden lloje bimore mjekësore, të dobishme, flotante (notuese), endemikesi dhe lloje të tjera të bimëve.

Gjatë kohës sëzbatimit të aktiviteteve të projektit, toka nuk do të vuajë asnjë lloj ndikimi apo shfrytëzimi. Për qasje deri te lokacioni, ekziston një rrugë lokale përgjatë shtratit të lumit Vodoçnicë, duke e bërë kështu më të lehtë shkuarjen deri në lokalitet.

Ndoshta lloji më domethënës i cili ekziston në Moçalin e Monospitovës është **fieri mbretëror** (*Osmunda regalis - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*). Ky është lokaliteti i vetëm në Maqedoni ku zhvillohet fieri mbretëror dhe atë në një hapësirë shumë të vogël. Prandaj, Komuna e Strumicës në vitin 1987 solli vendim të mbrojë fierin mbretëror si monument natyror (Gazeta Zyrtare e Komunës së Strumicës nr. 7/1987).

Këtu zhvillohet edhe Katërgjethëshi i gjinisë së ndryshme - *Marsilea Quadrifolia (Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël)* - një lloj fieri ujor me gjethe të cilat duken si katërgjethësh që notojnë përgjatë sipërfaqes së ujit.

Rrallë e më rrallë vërehet në Moçal. Kjo lloj bime përmendet në Konventën e Bernit si një specie e rrezikuar.

Përveç këtyre, ka edhe disa bimë që janë shumë të rralla në pjesë të tjera të Maqedonisë, por edhe këtu ka shpërndarje shumë të kufizuar. Disa prej tyre janë: Fieri i moçalit – (*Thelipteris palustris - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël),* smirna tamariks (*Tamarix smyrensis),* Bari me sy të kaltërt (*Sisyrinchium bermudiana),* orkideja ngjyrë vjollce *(Orchis laxiflora), Isoetes Phrygia,* amaranti me gjemba *(Amaranthus spinosus), Cladium mariscus (Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*) etj.

Foto nr. 19 Osmunda Regalis (fieri mbretëror)

Shumë pak dihet për faunën e merimangave të Moçalit të Monospitovës. Një nga zbulimet më të rëndësishme janë përcaktimi i pranisë së një merimange peshkatare (*Dolomedes plantarius*), e cila gjendet në IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) – lista e llojeve të rrezikuara.

Në Moçal jetojnë edhe shumë lloje të tjera të merimangave prej të cilave më të rëndësishme janë: *Mendoza canestrinii* -e cila për herë të fundit në Maqedoni është parë në vitin 1929 dhe pas 80 vitesh është gjetur ekskluzivisht vetëm në këtë Moçal.
Clubiona phragmitis dhe *Hypsosinga heri* – lloje të cilat në Maqedoni ekzistojnë vetëm në Moçalin e Monospitovës.

Në Moçalin e Monospitovës dhe rrethinën e tij janë regjistruar 11 lloje amfibesh dhe 16 lloje zvarranikësh:
Triturus vulgaris – Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (triton i thjeshtë)
Triturus karelinii - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (triton i madh)
Salamadra salamandra - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (picërraku)
Bombina variegate - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë me bark të verdhë)

Bufo viridis - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë e gjelbër)
Bufo bufo - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë e zakonshme)
Hyla arborea - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë peme)
Pelobates syriacus - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkoca këmbëshpatë)
Rana dalmatina - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkoca dalmatine/e shkathët)
Rana graeca - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë greke)
Rana ridibunda - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë e gjelbërt e moçalit)
Mauremys rivulata - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (bretkocë lumenjsh)
Emys orbicularis - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (breshkë pellgu)
Testudo hermanni - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (breshka e Hermanit)
Podarcis muralis - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (hardhucë muri)
Podarcis erhardii - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (hardhucë Maqedonie)
Lacerta trilineata - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (hardhucë e madhe e gjelbërt)
Lacerta viridis - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (hardhucë e gjelbërt)
Anguis fragilis - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (hardhucë e verbër pa këmbë)
Natrix tessellata - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (gajrpër johelmues)
Natrix natrix - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (gjarpër uji)
Dolichophis caspius - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (gjarpri i verdhë-hajduti i madh)
Elaphe quatuorlineata - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (gjarpëri i minjve)
Zamenis longissimus - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (nepërka e Aeskulapiusit)
Platyceps najadum - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (gjarpëri gjuajtës)
Coronella austriaca - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (gjarpëri i butë)
Vipera ammodytes - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël (nepërkë me brirë)

Tek gjitarët, e një rëndësie të veçantëështë prezenca e vidrës (*Lutra lutra - Statusi IUCN: thuajse të rrezikuara*), si dhe e tetë llojeve të lakuriqëve, edhe atë: lakuriqi Mehelian hundëpatkua (*Rhinolophus mehelyi - Statusi IUCN: i rrezikuar*), lakuriqi i madh hundëpatkua (*Rhinolophus ferrumequinum - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël),* lakuriqi i vogël hundëpatkua
(*Rhinolophus hipposideros - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), lakuriqi me krahë të gjatë (*Miniopteris schreibersi - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), lakuriq i vogël me veshë si të miut *(Myotis blythii- Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël),* lakuriq i madh me veshë si të miut *(Myotis myotis - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*) dhe lakuriqi gishtëgjatë (*Myotis capaccinii - Statusi IUCN: i rrezikuar*). Të gjitha këto lloje përfshihen si kafshë të mbrojtura në mënyrë strikte në listat e Konventës së Bernit dhe në Direktivën Evropiane të Habitateve.Sipas vlerësimeve më të fundit të Listës së Kuqe të Specieve të Rrezikuara - IUCN, lakuriqi Mehelian hundëpatkua, lakuriqi i vogël hundëpatkua dhe lakuriqi gishtëgjatë, janë përfshirë në kategorinë e specieve të rrezikuara.Vidra sipas Listës së Kuqe të Specieve të Rrezikuara - IUCN, në nivel global, kategorizohet si *specie afër rrezikut.* Numri i vidrës në Maqedoni po zvogëlohet gjithnjë e më shumë, kështu që është e nevojshme të fillohen aktivitete për ruajtjen e kësaj specieje shtazore dhe habitateve të saj.Vidra mund të jetë një nga speciet kryesore për ruajtjen e Moçalit të Monospitovës si habitat i saj.

Peshqit, përkatësisht peshkimi në Moçalin e Monospitovës para 50 viteve ka qenë aktivitet i rëndësishëm i një domethënie ekzistenciale për banorët lokal. Duke patur parasysh situatën aktuale në Moçalin e Monospitovës, (i thatë dhe me ujë me cilësi të keqe), nuk është për t'u habitur

që në vetë Moçalin haset një numër i vogël illojeve të peshkut. Ujërat që rrjedhin në Moçal, për shkak të konfigurimit të terrenit, gravitojnë drejt kanalit të Monospitovësi vendosur poshtë rrjedhës së vetë Moçalit. Rrjedhjae ujit nga pjesa e poshtme e malit Bellasicë është zvogëluar si rezultat i ruajtjes së burimeve të cilat gravitojnë në drejtim të Moçalit. Mund të thuhet se Moçali nuk është vendbanim ivazhdueshëm për shumicën e peshqve, por paraqet vend të rëndësishëm për lëshuarjen e vezëve të tyre. Kjo është veçanërisht e vërtetë për mlyshin (*Esox lucius – Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), i cili me siguri hyn në Moçalin e Monospitovës për të lëshuar vezët.

Të dhënat nga popullata lokale tregojnë se jo shumë përpara (para dhjetëra vitesh), mlyshi, së bashku me lloje të tjera të peshkut, u mbajtën gjatë gjithë vitit në pjesë të Moçalit të Monospitovës të cilat ishin vazhdimisht nën ujë.

Në ujërat e lumit Strumicë, hasen llojet e mëposhtme të peshkut: mlyshi (*Esox lucius*), pllaja (*Rhodeus amarus - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), barbelli i Strumicës (*Barbus strumicae - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), kunja e Strumicës (*cobitis strumicae - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), panja (*Squalius orpheus - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), si dhe llojet e futura: *Pseudorasbora parva, Carassius gibelio* dhe *Gambusia holbrooki - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*. Barbelli i Strumicës dhe kunjae Strumicës jetojnë në të njëjtat ujëra, por jo edhe në Moçalin e Monospitovës dhe pjesët e qeta të kanaleve.

Llojet e futura të peshkut janë tolerante ndaj ndotjes dhe janë lloje invazive që paraqesin kërcënim për peshqit vendas. Gambuzia (*Gambusia holbrooki*) është lloji i futur i një peshku për shkak të një lufte biologjike me mushkonjën e malaries. Deri më tani, nuk ka të dhëna relevante që tregojnë se ai ka ndikim në rënien e numrit të mushkonjës së malaries, por ka të dhëna se ndikon në llojet e peshkut vendas (autokton) dhe rrezikon seriozisht një numër të madh speciesh endemike.

Për shkak të tharjes së Moçalit të Monospitovës dhe livadheve të lagështa në rrethinën e tij, numri i lejlekëve që bëjnë fole në mjedisin e saj ka rënie të ndjeshme. Nuk ka të dhëna mbi atë se sa ka qenë numri i tyre para tharjes, por supozohet se ka tejkaluar 150. Në vitin 1958, numri i tyre në fshatra, në afërsi të Moçalit, arrinte të paktën 80, dhe në vitin 2007 u zvogëlua në vetëm rreth 20.

Gjithsej 112 lloje shpendësh janë regjistruar në Moçalin e Monospitovës, por ky numër me siguri nuk është numri përfundimtar dhe ndoshta e tejkalon numrin e 130 llojeve. Për fat të keq, pavarësisht numrit relativisht të madh të llojeve, në shikim të parë, habit numri i vogël i tekeve - tek shumë prej zogjve që janë karakteristike për habitatet ujore. Bëhet fjalë për praninë e vetëm disa çifteve ose tekeve. Një numër i madh i llojeve me interes për mbrojtje, ose me interes për vëzhguesit e zogjve, në Moçalin e Monospitovës, hasen shumë sporadikisht, nëse eventualisht mund të shihen.

Nga numri i përgjithshëm i llojeve, 48 janë të lidhura me habitatet e moçalit, ndërsa pjesa tjetër janë të lidhura me zonat e kultivuara në afërsi të menjëhershme, zonat e shkurreve ose vijnë nga vendbanimet përreth. 63 lloje konsiderohen si pika të sigurta foleje, por vetëm 19-21 prej tyre janë nga grupi i zogjve që lidhen me habitatet e moçalit, që është një numër shumë i vogël dhe tregon qartë gjendjen jo të favorshme të moçalit. Të paktën edhe katër lloje të tjera hasen në Moçalin e Monospitovës në kërkim të ushqimit, gjatë periudhës së foleve, edhe pse ato nuk bëjnë fole në të njëjtin vend. Përveç kësaj, nga të njëjtat grupe dimërore, hasen të paktën 7 lloje, ndërsa edhe më së paku 16 lloje të tjera mund të vërehen gjatë shpërnguljes.

Si fole-bërëse në Moçal çafka e vogël e moçalit (*Ixobrichusminutus - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), rosa e egër (*Anasplathyrynchos - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), pula e thjeshtë këmbëjeshile (*Rallusaquaticus - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël, Gallinulachloropus - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), gjeraqina e moçalit (*Circus aeruginosus - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), murgesha (*Vanellus vanellus - Statusi IUCN: pothuajse të rrezikuara*), disa lloje të kallameve (*Acrocephalus*spp.) dhe disa lloje të tjera gjerësisht të shpërndara. Në periudhën e folesë, pas ushqimit vijnë edhe lejleku i zi (*Ciconianigra - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), çafka ngjyrë hiri (*Ardeacinerea - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), çafka e vogël e bardhë (*Egrettagarzetta - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël*), shqiponja e vogël (*Aquilapomarina - Statusi IUCN: rreziku/shqetësimi më i vogël)* dhe lloje të tjera të cilat bëjnë fole në rrethinën e tij më të gjerë.

Gjatë dimrit ose gjatë shpërnguljes, haset edhe kredharaku i vogël (*Tachybaptus ruficollis - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), shumë lloje të rosave, si bajuka e zakonshme (*Anas crecca - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël),* pata e egër *(Anas Penelope - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël),* rosë e ujrave të freskëta *(Anas querquedula- Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël),* çafka, pulëbardha (*Chlidonias spp. - Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*) etj. Në mjedisin më të afërt të Moçalit të Monospitovës, në një numër të vogël (me një ose dy çifte), hasen lloje të ndryshme të zogjve grabitqarë (gjeraqina e veriut - Accipiter gentilis - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), harabeli eurazian/i veriut (Accipiter nisus - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), tarallaku – (Buteo buteo - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), tarallaku këmbë gjatë – (Buteo rufinus - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), shqiponja e gjarprit gishtëshkurtë– (Circaetus gallicus - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), sokoli i zakonshëm (Falco tinnunculus - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), bletëngrënësi (Merops apiaster - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), pupëza (Upupa epops - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), qyqja e zakonshme (Cuculus canorus - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), laureshat (lauresha e madhe - Melanocorypha calandra - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*) , lauresha polake – (Alauda arvensis - *Statusi: rreziku/shqetësimi më i vogël*), gllabëruesit (Hirundinidae), mëllenjat (Turdidae), zogjtë e shkurreve (Sylviidae), xhixhimes (Paridae), trishtili (Fringillidae), harabeli amerikan (Emberizidae) etj.

Lejleku i zi dhe shqiponja e vogël, janë në mesin e zogjve më të rrallë në Maqedoni, me një numër

të vlerësuar prej më shumë se 30 përkatësisht 10 çifte. Nga një çifti të dy llojeve, haset në Moçalin e Monospitovës gjatë periudhës së riprodhimit. Ata bëjnë fole në malet përreth, ndërsa në Moçalin e Monospitovës ata i përmbushin nevojat e tyre ushqimore. Të dy llojet janë shumë të ndjeshëm ndaj shqetësimeve.

Fotonr. 21 çafka e bardhë

Ekzistojnë më shumë kanosje për sa i përket mbijetesës së Moçalit të Monospitovës:

Ndryshimi i regjimit hidrologjik, gjegjësisht hidrografia e Moçalit të Monospitovës dhe mjedisit të tij ka filluar pas Luftës së Dytë Botërore, në vitin 1947. Përpara kësaj, sipërfaqja e hapur e ujit në Moçalin e Monospitovës zinte rreth 500 ha dhe është mbushur kryesisht nga lumenjtë Vodoçnicë, Trkanjë, Vodeniçnicë, Baba dhe lumi Barlenska si dhe nga ujërat e shumtë të rrëmbyeshëm dhe përrenjë që rrjedhin nga Bellasica. Me ndërhyrjet përmirësuese për tharjen e Moçalit, lumi Vodoçnicë u gërmua nga rruga para Moçalit deri në hyrjen e tij në lumin Strumicë (dhe që atëherë njihet edhe si Kanali i Monospitovës) me qëllim të kullimit të ujërave të Moçalit të Monospitovës. Së bashku me Kanalin e Monospitovës, u gërmua edhe Kanali i Rinisë me një gjatësi prej 16 km në bazamentin e Bellasicës, me qëllim që të marrë pjesën më të madhe të ujërave nga Bellasica që mbushën Moçalin.

Me gërmimin e dy kanaleve të përmendura, pjesa ligatinoreeMoçalit është reduktuar maksimalisht dhe sot është reduktuar në disa puse ku niveli i ujit ndryshon në varësi të kushteve atmosferike. Pas ndërhyrjeve të para për përmirësim në vitin 1947, pasuan disandërhyrje (në periudhën nga viti 1963 deri në vitin 2006), të cilat intensifikuan kullimin e Moçalit. Gjatë 20 viteve të fundit, situata me Rrjetin Hidrologjik të Moçalit tëMonospitovës dhe zonat përreth është në ndryshim të vazhdueshëm. Disa nga kanalet e vjetra të gërmuara janë bllokuar për shkak të mosmirëmbajtjes, ndërsa janë gërmuar kanaletë reja për shkak të interesave të fermerëve lokalë. Të gjitha këto ndryshime në

regjimin hidrologjik ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe shtazore, si dhe nëfragmentimin e habitateve.

- **Shkatërrimi dhe degradimi i habitateve –** shkatërrimi i habitateve/vendeve të strehimit është kërcënimi më serioz aktual i identifikuar në Moçalin e Monospitovës. Erozioni apo tharja e sipërfaqeve të moçalit, si dhe prerja dhe djegia e trungjeve dhe bimëve të tjera, me qëllim që të zmadhohet sipërfaqja pjellore për qëllime bujqësore, është e pranishme në të gjitha pjesët periferike ku është kufiri me zonat bujqësore . Humbja e habitateve është reflektuar në të gjitha grupet e bimëve dhe kafshëve. Speciet që jetojnë në ekosistemet ujore karakterizohen nga përshtatje të ngushta dhe shkatërrimi i habitateve të tyre, në mënyrë të pashmangshme çon në një reduktim drastik të numrit të tyre dhe zhdukje të plotë. Me djegien e trungjeve, drejtëpërdrejtë shkatërrohen habitatet, foletë e zogjve dhe një pjesë e rëndësishme e burimeve ushqimore: (pakurrizorë të ndryshëm që jetojnë në Moçalin e Monospitovës). Duhet patjetër të përmendet se nga djegia nuk kursehet as fieri mbretëror në afërsi të fshatit Bansko.
-

- **Eutrofikimi dhe ndotja e ujrave –** eutrofikimi dhe ndotja e ujrave është një kërcënim serioz për larminë biologjike në Moçalin e Monospitovës.Pjesa më e madhe e materieve ndotëse hyjnë nëpërmjet daljes apo lëshimit të vazhdueshme të ujrave të zeza fekale në Vodoçnicë, e cila me vete i merr ujrat e zeza komunale të qytetit të Strumicës (kanalizimit fekal). Përdorimi i vazhdueshëm dhe i pakontrollueshëm i mjeteve kimike (plehrat natyror dhe artifical, pesticidet), në hapësirat bujqësore të rrethit në mënyrë domethënëse e shpeshtojnë ndotjen e ujrave në Moçalin e Monospitovës. Gjithashtu, prezenca e objekteve industriale në territorin e Moçalit, paraqet kërcënim plotësues dhe serioz. Dëshmi për cilësinë jo të mirë të ujit është prezenca e α-indikatorëve diatomik. Disa lloje të peshqve (*Pseudorasbora parva, Gambusia affinis, Carassius gibelio*), të cilët janë në numër të madh në kanale janë indikatorë për ujra mjaft të ndotura. Përdorimi i tepërt i kemikaleve në bujqësi shkakton probleme të mëdha në banorët e ujit dhe zvarranikët. Ndikimi i këtyre helmeve mund të jetë i drejtëpërdrejtë ose i vonuar. Ndikimi i vonuar paraqitet kur këto kemikale do të kyçen në zinxhirin ushqimor dhe kanë efekt kumullativ, ashtuqë vdekshmëria më e madhe paraqitet vitin e ardhshëm kur këto shtazë zgjohen nga gjumi dimëror dhe janë dobësuar nga periudha e gjatë pa ushqim. Përdorimi i plehrave dhe preparatet kimike në bujqësi, padyshim shkakton ndotje të tokës dhe me këtë edhe ndotje të prodhimeve bujqësore të cilat shfrytëzohen në ushqimin e njeriut dhe kafshëve shtëpiake. Ndotja e ujërave nëntokësorë të cilat shfrytëzohen si ujë për pije (çeshme arterike, puse) janë kërcënim i drejtëpërdrejtë për shëndetin e popullatës lokale në afërsi të Moçalit të Monospitovës.

Gjuetia në R. e Maqedonisë, sipas rregullativave ligjore trajtohet si veprimtari e veçantë profitabile ekonomike.Sipas Ligjit për Gjueti të R.M-së, 127 lloje të faunës së egër janë shpallur si egërsira. Si egërsira të vogla dhe të mëdhaja të rrezikuara janë: lepuri i egër, kaprolla, dreri, ndërsa si zog i rrezikuar është thëllëza të cilat janë të përfshira në territorin e komunës. Kjo lloj egërsire është e kategorizuar si egërsirë "e mbrojtur nga gjuetia", përveç drerit i cili është në kategorinë e egërsirëssë mbrojtur afatgjate, mbijetesa afatgjate e tëcilit është e rrezikuar.Rrezikimi

i këtyre llojeve vjen më së shumti nga numri i madh i gjuetarëve dhe gjuetarëve hajdutë dhe politika ndëshkuese e pamjaftueshme dhe e ngadaltë kundër gjuetisë së jashtligjshme.

Gjuetia si veprimtari profitabile ekonomike mundëson të ardhura devizore, punësim, zhvillim të hotelierisë, turizmit, transportit, pylltarisë, etj.

Gjuetia e tepëruar e zogjve në Moçalin e Monospitovës dhe rajonin më të gjerë, paraqet kërcënim shumë të rëndësishëm për zhdukjen e tyre, sidomos të llojeve të mbrojtura.

Gjithashtu, është regjistruar edhe dukuria e gjuetisë së jashtligjshme në këtë lokalitet. Përdorimi i kurtheve, para së gjithash për kapjen e vidrave të cilat shpeshherë në kërkim të ushqimit hyjnë në pellgjet e peshqve, është praktikë e zakonshme në moçal. Gjuetia e jashtligjshme e peshqve më së shumti është e shfaqur në periudhën e lëshimit të vezëve nga mlyshi, kur lloji është më i prekshëm, me çka rrezikohet mbijetesa e tij në Moçalin e Monospitovës. Gjuetia dhe gjuetia e jashtligjshme janë një nga arsyet kryesore edhe për numrin më të vogël të zogjve. Presioni jashtëzakonisht i madh i gjuetisë me siguri më i madh nga çdo vend tjetër në Maqedoni do të thotë shkatërrim i drejtëpërdrejtë i shumë zogjve, dhe shqetësim i madh i atyre tëcilët do tu largohen shënjestrave. Është evidente edhe jo-selektimi i gjuetisë, përkatësisht objekti i shënjestrës janë edhe llojet të cilat janë nën mbrojtje afatgjate, dhe nuk kanë domethënie në ushqimin e njerëzve.

Gjuetia e jashtëligjshme bëhet edhe natën, me ç'ka nuk sigurohet strehë edhe për ato pak zogj, të cilët do të zbresin në moçal për pushim dhe ushqim. Për fat të mirë, kjo gjendje mundet lehtësisht të përmirësohet nëpërmjet zbatimit të ndalimit tëpërhershëm të gjuetisë, që për periudhë më të shkurtër kohore (1 deri në 2 vjet) do të shpie deri në zmadhim domethënës të numrit të zogjve. Prandaj gjuetia kontrollohet nga ana e SHGJ Goce Dellçev nga Bosilova, nëpërmjet shërbimit të zhvilluar të rojeve, si dhe personit përgjegjës në vetë lokacion për mbrojtjen fizike të Moçalit nga zjarret, uzurpimi, shkatërrimi, dhe veprime të tjera të ngjashme të padëshiruara.

Foto nr.22 Moçali i Monospitovës

Foto nr.23 Moçali i Monospitovës

Foto nr.24 Moçali i Monospitovës

Gjuetia në komunë është zhvilluar nëpërmjet vendgjuetisë së Shoqatës së gjuetarëve Goce Dellçev nga Bosilova, e cila kujdeset për egërsirat dhe për trajtimin e duhur të tyre(kultivimi, mbrojtja, ushqyerja etj). Vendi i gjuetisë ka shërbimin e tij të rojeve. Sipërfaqja e përgjithshme e vendit të gjuetisë është 14.420 hektarë prej të cilave 13.820 hektarë janë sipërfaqe gjuetie. Nga llojet e egërsirave të gjuetisë më së shpeshti hasen: derri i egër, dhelpra, thëllëza, fazani, ujku, lepuri etj., egërsira flutуruese: breshkat flutуruese, shkurtat, pëllumbat, shtegtarët, etj.

Në komunë ka një pellg peshku më të madh, ku ruhet peshku në mënyrë natyrore dhe i njëjti është në rrethinën e fshatit Monospitovë në afërsi të Moçalit.Pellgu i peshkut është pronë prinate me sipërfaqe rreth 1 hektar.Kapaciteti i pellgut të peshkut është 6000-8000 peshq në vit për të cilët është e nevojshme 1.4 ton ushqim në vit.

2.9 Planifikimi urbanistik dhe hapësinor

Dokumentacioni urbanistik i vazhdueshëm për komunën Bosilovë, nuk i kënaq standardet sepse është mjaft i vjetër, prandaj për këtë është e nevojshme i njëjti të zëvendësohet me të ri në drejtim të planifikimit më të mirë të zhvillimit të komunës dhe shfrytëzim maksimal të hapësirave dhe mundësive hapësinore të saj.

Për momentin, komuna disponon me dokumentacionin urbanistik vijues:

- Hamzali (plan urbanistik jashtë vendbanimit)
- Robovë (plan urbanistik për një pjesë të fshatit Robovë, ndryshim dhe plotësim me një zone ekonomike).

Kushtet për ndërtim, ose miratimet për ndërtim jepen në bazë të dokumentacionit urbanistik të sipërpërmendur në pajtim me Ligjin për ndërtim.
Ekzistojnë sipërfaqe të mëdha të pandërtuara për ndërtim të cilat gjenden në pjesët ndërtuese të vendbanimeve, dhe të cilat nuk janë në pronësi të komunës që në masë të madhe ndikon në mundësitë për krijim të zhvillimit lokal ekonomik të saj, nëpërmjet shitjes së tyre investitorëve potencial vendas dhe të huaj.

3. Ndikimet ndaj mjedisit jetësor

Plani për menaxhim me mjedisin jetësor synon ti vlerësojë ndikimet potenciale ndaj mjedisit jetësor dhe shoqërisë në pajtim me aktivitetet e parapara.

3.1. Emisionet (zbërthimet) në ajër

Lokacioni i nën-projektit është relativisht vend i qetë, pa komunikacion intensiv i cili do të ndikonte në mënyrë dramatike ndaj mjedisit jetësor dhe ndotjes së ajrit. Me ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së planifikuar, nuk priten ndryshime të dukshme në cilësinë e ajrit, duke patur parasysh se vëllimi i punës është i kufizuar në ndërtimine vendparkimit të përshtatshëm të lokacionit i cili tashmë shfrytëzohet për atë dhe instalim të sistemit për ngrohje qëndrore me peleta, që do të thotë përmirësim sepse për momentin shfrytëzohen soba me dru.

Ndotësit e vetëm të ajrit në fazën e ndërtimit do të jenë automjetet dhe makineritë të cilat do të shfrytëzohen nga ana e kontraktuesit. Megjithatë, parashikohet që ajo të jetë ndotje minimale me kohëzgjatje të shkurtër (në kohën e kryerjes së punëve) dhe nuk do të ketë ndikim serioz mbi cilësinë e ajrit.

Prandaj, nuk ekziston ndikim negativ potencial nga realizimi i këtij nën-projekti mbi cilëndo fushë të ndjeshme të mjedisit jetësor. Si përfundim, nuk do të ketë shpërndarje plotësuese të ndotësve të ajrit të cilët do të kishin ndikim të dukshëm mbi mjedisin jetësor.

Projekti i planifikuar për ndërtim dhe rindërtim nuk parasheh shfaqjen e pengesave të cilat do të ndikonin në ndryshim të drejtimit të erës, ashtuqë mos prisni ndikim të dukshëm plotësues klimatik mbi hapësirat e përmendura, për dallim nga ajo që është përshkruar dhe që është tipike për këtë rajon.

Në fazën operative nuk do të ketë emisione në ajër, përveç atyre nga përdorimi i peletave për sistemin e ngrohjes qëndrore në kuadër të Qendrës. Ndikimi i këtillë do të jetë afatgjat, me domethënie të vogël dhe intensitet, si dhe me karakter lokal (njëjtë ose më pak ndikim në krahasim me gjendjen momentale – shfrytëzimin e drurit për ngrohje).

3.2. Emisione në uj dhe kanalizim

Gjatë kohës së aktiviteteve të cilat do të bëhen gjatë ndërtimit dhe rindërtimit, të parapara në nën-projekt, nuk priten asnjë lloj emisionesh në ujrat nëntokësore dhe sipërfaqësore, dhe as në kanalizimin atmosferik. Me rëndësi të veçantë është që të largohet rrjedhja e vajit dhe gazit nga makineritë të cilat do të shfrytëzohen gjatë kohës së ndërtimit dhe kontakti i drejtpërdrejtë i tyre me tokën dhe në mënyrë të tërthortë edhe me ujërat nëntokësorë, më saktësisht me burimet ujore.

Do të mundësohen pajisje sanitare për punëtorët (toalete të montuara ose infrastruktura ekzistuese).

Aktivitetet projektuese në lokacion (brenda zonave me baltë) do të kryhen gjatë verës kur toka është e thatë dhe nuk ka ujë, dhe mbi të gjitha automjetet e rënda dhe pajisjet elektrike nuk do të përdoren gjatë rindërtimit të infrastrukturës prej druri, kështu që nuk do të ketë kushte për ç'farëdo lloj shkarkimi në ujë. Materialet që do të përdoren për rinovimin, sidomos të drurit, nuk do të trajtohen me ndonjë agjent (shtresim, etj) dhe ngjyra. Asnjë shenjë anti-korrozion nuk do të zbatohet në lokacion.

3.3. Emisione në tokë

Aktivitetet projektuese të cilat do të kryhen nuk do të kenë ndikim ndaj tokës, sepse nuk do të shfrytëzohen mjete të rënda dhe paisje elektrike gjatë rindërtimit të infrastrukturës së drurit, punët rindërtuese do të kryhen me dorë dhe rrethimi i drejtpërdrejtë i infrastrukturës së drurit do të trajtohet me vëmendje dhe në përputhje me procedurën e caktuar. Nuk do të ketë mbeturina të cilat do të mbesin mbi tokë dhe mbeturinat komunale të krijuara nga ana e punëtorëve të angazhuar do të grumbullohen në kontejnerë përkatës dhe më pas do të transportohen me automjete. Kontraktuesi nuk do të lejojë asnjë rrjedhje të vajit të motorrave të automjeteve të cilat do ti kryejnë aktivitetet e parapara infrastrukturore. Këto masa të kujdesit do ti mbrojnë edhe ujrat nëntokësor.

Aktivitetet projektuese duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos mundësojnë emisione të rastit në tokë, si dhe do të pamundësohet dëmtim i strukturës së tokës nga automjetet. Në emisionet e mundshme të paqëllimshme, bëjnë pjesë rrjedhja e derivateve, vajit, lubrifikantë dhe kemikale të tjera, si dhe shkatërrim i pjesës së sipërme të tokës për shkak të shiut dhe erozionit. Kontraktuesi duhet të marrë parasysh masat e kujdesit dhe ato lehtësuese të dhëna në tabelën e Planit për lehtësim, siç është paraqitur më poshtë, me qëllim që të parandalojë rrjedhjen e mundshme të karburantit ose vajit të motorrit në tokë nga makineritë e angazhuara nga kontraktuesi.

Ekzekutimi i punimeve në lokalitetin Moçali i Monospitovës (rinovimi i infrastrukturës prej druri) nuk do të shkaktojë ndonjë ndikim në tokë, sepse do të përdoret vetëm druri.

3.4. Zhurma, dridhjet dhe rrezatimijo-jonizues

Fjala „zhurmë“nënkupton ç’do tingull të pakëndshëm që veshi i njeriut vështirë se e duron. Zhurma si fenomenfizik kompleksmvaret nga intensiteti, kohëzgjatja dhe shpeshtësia, dhe ndikon negativisht në gjendjen psiko-fizike gjatë dhe pjesërisht e dëmton dëgjimin.

Pritet shfaqja e zhurmës për shkak të përdorimit të automjeteve, makinerive dhe mjeteve elektrike nga ana e kontraktuesit.

Shfaqja e zhurmës nga automjetet e kontraktuesit gjatë punës do të ketë shumë pak ndikim negativ, për shkak të faktit që ajo do të ketë kohëzgjatje të kufizuar dhe karakter lokal.Emisionet e zhurmës do të ishintë parëndësishme nëse kontraktuesi përdor automjete dhe makineri ndërtimi, në përputhje me standardet teknike dhe punët ndërtimore kryhennë bazë ditore (7-19).

Gjatë kryerjes së punimeve në Qendrën për turizëm alternativ (në lokacionin e planifikuar për përgatitje dhe montim të paisjeve) do të ketë zhurmë nga paisjet elektrike, por për shkak se përgatitja dhe montimi do të kryhet brenda, ndikimi do të jetë shumë i vogël mbi mjedisin e jashtëm dhe njerëzit që jetojnë në afërsi.

3.5. Krijimi i mbeturinave

Gjatë kohës së ndërtimit të vendparkimit, montimi i paisjeve dhe rindërtimit të shtigjeve prej druri, shtëpizave prej druri, dhe vëzhguesve, sasia e mbeturinave do të variojë. Krijimi i mbeturinave nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndotë mjedisin e afërt në mënyrë potenciale. Pothuajse të gjitha mbeturinat do të grumbullohen dhe do të krijohen gjatë kohës së fazës së ndërtimit. Sipas listës së llojeve të mbeturinave, një pjesë e madhe e mbeturinave të cilat do të krijohen gjatë kohës së aktiviteteve projektuese kategorizohen si mbeturina ndërtimore dhe mbeturina nga shembjet/rënoja, por do të ketë edhe krijim të sasive të vogla të mbeturinave të rrezikshme për shembull për shkak të derdhjes së rastësishme të vajit të makinerive, lubrifikantë, derivate dhe substanca të tjera të rrezikshme, shtresa të mbetura dhe paketime të kontaminuara. Blerja dhe montimi i paisjeve për Qendrën mund të krijojë mbeturina të parrezikshme (letër, karton, plastikë, dhe materiale tjera sintetike) për shkak të ambalazhimit të paisjeve (mbeturina prej paketimeve).

Mbeturinat e palëvizshme të cilat do të krijohen bëjnë pjesë në kategorinë e mbeturinave të parrezikshme. Këto nuk ndikojnë negativisht ndaj mjedisit jetësir, por përsëri është e nevojshme të ketë lokacion ku ato mbeturina do të zhvendosen. Mbeturinat e palëvizshme (psh. dheu, betoni, gurët e dërrmuar dhe tjegullat, etj.) mund të mbulojnë sipërfaqe të mëdha dhe mund t’a çrregullojnë pejsazhin. Pjesa më e madhe e tokës së gërmuar do të përdoret për rimbushje dhe do të deponohet për përdorim të mëtejshëm mbi sipërfaqe të përkohshme. Sasitë e mbeturinave do të jenë minimale nëse zbatohet menaxhim i drejtë me mbeturinat duke përdorur teknikat më të mira për zvogëlim

të mbeturinave gjatë kohës së fazës së ndërtimit dhe gjatë kohës së fazës operative. Obligimi për sistemimtë mbeturinave që do të krijohen gjatë kohës së kryerjes së aktiviteteve projektuese, i përket kontraktuesit të punës.

Mbeturinat ndërtimore të krijuara do të transportohen deri në deponinë ligjore më të afërt. Mbeturinat nga rindërtimi i infrastrukturës së drurit nga aktivitetet e tjera do të deponohen në një lokacion të përkohshëm jashtë moçalit dhe më vonë do të transportohen në ndërmarrjen komunale "Ograzhden"-Bosilovw që më pas të njëjtat të zhvendosen në ndonjë deponi ligjore.

3.6.Ndikime ndaj natyrës, vendbanimeve dhe llojeve

Moçali i Monospitivws është vendbanim natyror i shumë llojeve bimore dhe shtazore. Si vendbanim hapësinor për shumë lloje, ai është destinacion i veçantë për ekosistemin natyror në rajon.

Aktivitetet projektuese të cilat do të kryhen në lokacionin e paraparë për projektin në Moçalin e Monospitovës, do të planifikohen dhe zbatohen me kujdes me qëllim që mos të shqetësohet bota e gjallë dhe mos shkatërrohen vendbanimet natyrore.

Është e mundur që të paraqiten ndikime negative ndaj botës së gjallë gjatë kohës së fazës së ndërtimit, për shkak të numrit të madh të njerëzve në lokacion. Ekzistonmundësia që të shqetësohet bota e gjallë për shkak të zhurmës e cila mund të krijohet nga aktivitetet rreth rindërtimit. Gjithashtu, ekziston rrezik nga ndezja e rastësishme e zjarrit dhe hedhja e mbeturinave. Këto ndikime janë lokale dhe të kufizuara në lokacion ku do të kryhen aktivitetet rreth rindërtimit dhe mundësia për paraqitjen e tyre është e vogël.

Ambienti natyror i mjedisit jetësor do të ruhet dhe promovohet me kujdes. Punëtorët që do të punojnë në vetë lokacionin do të njihen me procedurat të cilat duhet ti ndërmarrin me qëllim që mos ta prishin ekosistemin natyror.

Asnjë nga materialet që do të përdoren nuk do të jetë toksik për mjedisin jetësor, natyrën (sidomos atë ujore) dhe njerëzit. Nuk do të ketë trajtim të drurit (me shtresa, ngjyra, etj.) dhe nuk do të ketë trajtim të materialeve të tjera të cilat do të përdoren në atë lokacion(psh. Përdorimi i anti-ndryshkut). Rinovimi dhe rindërtimi i shtëpizave prej druri, shtigjeve dhe vëzhguesve do të mbesë në kuadër të madhësisë dhe dizajnit ekzistues.

Në fazën operative ekziston mundësia e krijimit të një sasie më të madhe të mbeturinave për shkak të numrit të pritshëm të turistëve. Rreziku kryesor për botën e gjallë është status kvo për shkak të asaj se i njëjti është i lidhur me shpalljen e moçalit si monument natyror. Mospasja e një organi zyrtarpërgjegjës për mbrojtjen dhe menaxhimin rrit mundësinë për gjueti të kafshëve në sezoninn e shumimit, gjuetinë e jashtligjshme, mbledhje jo e lejuar dhe shfrytëzim jo racional i botës bimore dhe shtazore si dhe shkatërrimin e botës aktuale të gjallë. Mungesa e organizatës për menaxhim, përgaditja për plan për menaxhimin dhe përkrahje financiare nga shteti mund të sjellë deri në përplasje, të vlerësuara si afatgjate dhe paraqitje të përsëritur.

Ne konsiderojmë se ndikimet ndaj natyrës, llojeve dhe vendbanimeve do të minimizohen pa rrezik nga ndonjë kanosje serioze – për shkak se një kohë të gjatë ne angazhohemi të mbrojmë këtë larmi biologjike natyrore.

3.7. Ndikime shoqërore

Pritet që zbatimi i këtij nën-projekti të jap benefite pozitive socio-ekonomike në rajon përmes mundësive të rritura për punësim, si dhe përmes një qasjeje të përmirësuar dhe tregu më të mirë për të mirën dhe shërbimet. Nën-projekti nuk parasheh marrje të tokës private ose zhvendosjen e banorëve vendas.

Benefiti më i madh do të jetë mundësi për eko-turizmin rural, zhvillimine zanateve lokale dhe zhvillimine ekonomisë lokale. Vendosja e këtij lokacioni në hartën turistike do të mundësojë informim më të mirë të turistëve dhe do të krijojë mundësi për zhvillim të mëtejshëm. Sigurisht që benefitet pozitive socio-ekonomike që dalin nga ky projekt do të jenë më të mëdha nga efektet negative ndaj natyrës dhe mjedisit jetësor, me ç'ka shpjegohet justifikueshmëria e zbatimit të këtyre aktiviteteve projektuese.

4. Masa për lehtësim

Masat për lehtësim që janë përshkruar në këtë pjesë janë të përgjithshme, ndërsa masat e obligueshme të detajuara për lehtësim janë dhënë në tabelë në kapitullin për Planin për lehtësim dhe vëzhgim.

Kontraktuesi duhet të dakordohet me të gjitha kërkesat me qëllim që të eliminohet mundësia për lëndime potenciale të punëtorëve, banorëve lokal dhe turistëve. Të gjitha aktivitetet rreth rindërtimit duhet të kryhen nga ana e punëtorëve të trajnuar.

Palët e ngarkuara për zbatimin e programit për mbrojtje të mjedisit jetësor janë:

1. Kontraktuesi (firma e zgjedhur në tender)
2. Inxhinier-mbikqyrës
3. Aplikuesi (shfrytëzuesi) / Komuna Bosilovë.

4.1. Ajri

Gjatë kohës së punimeve ndërtimore, ndjekja e masave preventive duhet të zbatohet me qëllim që të minimizohet ndikimi negativ ndaj ajrit.

- Përcaktimi i kujdesshëm i kohës për punë në vendparkim (në vendbanimin Monospitovë).-Kufizim i trafiku të panevojshëm të lokacionit ku kryhen punimet ndërtimore. – Zbatimi i mirëmbajtjes së rregullt të automjeteve dhe mekanizmave ndërtuesese dhe riparime të rastit me qëllim që të ulen emisionet (zbërthimet).

-Përdorimi i karburantit cilësor për automjetet (në përputhje me standardet kombëtare).Përdorimi i paisjeve mbrojtëse, si për shembull maskat për punëtorët kur punojnë në kushte me pluhur. Sigurimi i masave mbrojtëse për automjetet dhe paisjet – e sidomos masa për mirëmbajtjen e instalimit (tubave) për gazrat e shkarkimit, filtrave për vajin e motorrit dhe servisimi i rregullt i paisjeve.

4.2. Uji

Gjatë kohës së punimeve ndërtimore, duhet të aplikohet ndjekja e masave prventive me qëllim që të minimizohet ndikimi negativ ndaj ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

- kryerja e mirëmbajtjes së rregullt të automjeteve dhe mekanizmave ndërtuese dhe riparime periodike në përputhje me procedurat me qëllim që të zvogëlohet rrjedhja, emisionet dhe spërkatja (gjatë kohës së ndërtimit). Mirëmbajtja dhe riparimet e automjeteve dhe mekanizmave ndërtuese është e ndaluar të bëhet në vetë lokacionin e ndërtimit (vendparkimin).

-Automjetet dhe mekanizmat ndërtuese të kontraktuesit shrytëzojnë rrugë qasëse ekzistuese.

- Përzgjedhje e kujdesshme e lokacionit për materialet ndërtuese, deponitë/transportim i mbeturinave ndërtimore (lokacionet duhet të parashikohen në kuadër të lokacionit për ndërtim të vendparkimit).

4.3. Toka

Gjatë kohës së punimeve ndërtimore, duhet të zbatohet ndjekja e masave preventive me qëllim që të minimizohet ndikimi negativ ndaj tokës:

- Planifikim i kujdesshëm i punëve ndërtimore me qëllim që të zvogëlohen efektet negative dhe të mundësohet ndërprerje e ndotjes së tokës. –Zvogëlimi i madhësisë së lokacionit për shkak të minimizimit të tokës e cila do të kalojë ndikime negative (të giitha aktivitetet ndërtimore të parapara duhet të kryhen në kuadër të lokacionit që është parashikuar për ndërtim të vendparkimit). –Kufizim i lëvizjes së automjeteve dhe shfrytëzim i makinerisë që sjell më pak presion ndaj tokës. –Të gjitha materialet e rrezikshme, si për shembull, karburanti, lubrifikantët, ngjitëset, si dhe mbeturinat e ambalazhuara janë mbeturina jo inerte dhe të njëjtat duhet të zhvendosen në kontejnerë të përshtatshëm të veçantë (të përshtatshëm për pranim dhe deponim të ç'do lloj materiali)të vendosur në lokacionin e ndërtimit, të mbrojtura nga kushtet atmosferike ekstreme(shi, erë).

-Mbrojtja e materialeve ndërtimore dhe ndërprerja e aktiviteteve ndërtuese në kushte të shirave të rrëmbyeshëm.– Fusha e lokacionit të ndërtimit do të jetë e kufizuar.

-Të gjitha huazimet e çakallit dhe rërës, më saktësisht vendet ku teprica e materialit të gërmuar do të hidhet duhet patjetër të posedojnë leje/miratim adekuat.

4.4.Zhurma

Gjatë kohës së punimeve ndërtimore, duhet të aplikohet ndjekja e masave preventive me qëllim që të minimizohet ndikimi negativ i zhurmës:

- aktivitetet ndërtimore mund të kryhen vetëm gjatë ditës (07-19) siç është përcaktuar me lejen e marrë.

- aktivitetet ndërtimore duhet të planifikohen në mënyrën e duhur me qëllim që të zvogëlohet koha e shfrytëzimit të paisjeve që krijojnë zhurmë më të madhe.

- Për shkak se bëhet fjalë për zonë të banueshme urbane (vozitje nëpër qytet deri te lokacioni), niveli i zhurmës nuk guxon të tejkalojë 55 decibel gjatë ditës dhe 45 decibel gjatë natës.

- gjatë kohës së veprimit, kapakët për gjeneratorët e motorrëve, kompresorët për ajër dhe paisjet e tjera mekanike për të cilat nevojitet furnizim me energji elektrike, duhet të jenë të mbyllura dhe paisjet duhet të vendosen sa më larg që është e mundur nga zona e banueshme.

- përdorim i praktikave më të mira ndërtimore me theksim të veçantë të niveleve të zhurmës.

4.5. Mbeturinat

Gjatë kohës së punimeve ndërtimore, duhet të zbatohet ndjekja e masave preventive me qëllim që të minimizohet ndikimi negativi mbeturinave:

- vendosja e kontaktit me mbledhësit e autorizuar, transportuesite llojeve të ndryshme të mbeturinave dhe bërja të mundshme e sistemimit përfundimtar të sigurt. Mbeturinat e krijuara duhet të vendosen në lokacione të veçanta ku ndërtohet vendparkimi, ku do të shënohet lloji i mbeturinave (të rrezikshme/jo të rrezikshme/inerte) deri në momentin e grumbullimit, transportimit dhe sistemimit përfundimtar. Automjetet që do të transportojnë mbeturinat nga lokacioni i ndërtimit duhet të jenë të mbuluara në mënyrë që të ndërpritet përhapja e tyre. – Aktivitetet ndërtimore do të përfundojnë vetëm atëherë kur të gjitha mbeturinat ndërtimore do të largohen (nuk guxon të ngelen mbeturina në vendin e ndërtimit)/ do të grumbullohen nga ana e shërbimeve të autorizuara. –Është e ndaluar të ndizen mbeturinat në vendin e ndërtimit.

- Klasifikimi i mbeturinave në përputhje me Listën kombëtare të mbeturinave (Gazeta zyrtare nr.100/05),

Mbeturinat kryesore duhet të klasifikohen sipas Kapitullit për mbeturinat 17 “Mbeturina nga ndërtimi dhe prishja (përfshirë këtu edhe dheun e gërmuar) “ dhe Kapitulli për mbeturina 20 „Mbeturina komunale (mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina të ngjashme nga aktivitetet komerciale, industriale dhe administrative) duke përfshirë pjesë nga mbeturinat e selektuara”. – Mbeturinat e krijuara, nëse është e mundur, duhet përsëri të shfrytëzohen si material ndërtimor (me miratim nga inxhinieri-mbikqyrësi, shfrytëzuesi dhe eksperti për mjedisin jetësor i PKLR). – Mbeturinat ndërtimore do të vendosen në deponi për mbeturina inerte.

- mbeturinat që do të krijohen gjatë kohës së qëndrimit dhe punimeve të kontraktuesit, me zbatim të praktikave më të mira për menaxhim, duhet të grumbullohen, transportohen dhe vendosen në deponi që i plotëson standardet themelore në përputhje me aktet ligjore.

4.6. Larmia biologjike (flora dhe fauna)

Gjatë kohës së punimeve ndlrtimore, duhet të zbatohet ndjekja e masave preventive me qëllim që të zvogëlohet ndikimi negativ ndaj larmisë biologjike (florës dhe faunës):

-Hapësira që do të mbulohet nga punimet ndërtimore duhet të reduktohet në minimum në vendin e ndërtimit gjatë fazës së planifikimit.Nuk do të ketë pastrim të tokës dhe asnjë gjelbërim i madh nuk do të hiqet në vendin natyror. Në rast se nuk mund të shmanget heqja e pemëve nga mjedisi i drejtëpërdrejtë i vendparkimit, si dhe pemëve të larta nga fusha para ndërtesës, kjo do të bëhet vetëm pas marrjes së lejes me shkrim nga autoritetet kompetente (për shembull, shërbimet për menaxhimin e pyjeve).

- Është e ndaluar mbledhja e drunjve për ngrohje nga dhe rreth hapësirës punuese.

- Plani për punë do të shqyrtohet dhe do të miratohet nga ana e një eksperti për mbrojtjen e natyrës/biolog. Punimet në zona natyrore të ndjeshme (moçal)do të mbikqyren nga një ekspert.

- Punimet gjatë kohës së periudhave të ndjeshme (psh.shumimi)për llojet e cënuara dhe (pothuajse) të rrezikuarado të shmangen.

- Është i ndaluar shqetësimi i kafshëve dhe mbledhja e bimëve në atë zonë.

–Për rinovimin, do të përdoret vetëm dru që prodhohet në lokalitet me prejardhje të vërtetuar dhe lloj identik me drunjtë e vendosur më parë.

- Nuk guxon të hiqet hapësira e gjelbërt. Nuk do të dëmtohen apo hiqen drunjtë gjatë kohës së punimeve në Moçalin e Monospitovës.

5. Plan për menaxhimin e mjedisit jetësor dhe aspektet shoqërore

5.1 Plani për lehtësim

Komuna Bosilovë është përgjegjëse për përputhshmërinë e projektit me mjedisin jetësor, zbatimin e projektit dhe veprimin në suaza të legjislacionit kombëtar, të këtij PMMJ dhe në kuadër të masave të cilat ai i definon, si dhe në kuadër të KMMJ-së (Kornizës për menaxhim me mjedisin jetësor) të të gjithë projektit. Mbikqyrja e aspekteve të mjedisit jetësor dhe aspkteve shoqërore, siç është definuar në Planin për mbikqyrje, është përgjegjësi e komunës së Bosilovës. Komuna Bosilovë do të jap raporte për përputhshmërinë me mjedisin jetësor si dhe për plotësimin e masave për ruajtje të mjedisit jetësor dhe për mbikqyrjen e procesit përprogres të NJZP (Njësiti për zbatim të projektit) në raportet për progresin e rregullt të projektit, si dhe në raportet tremujore gjatë kohës së periudhës së zbatimit.

Plani i përgaditur për mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore për këto nënprojekte do të jetë pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe të kontratës për të gjitha aktivitetet e projektit. Kontraktuesi do të jetë i obliguar ti zbatojë masat e parapara në pajtim me Planin për lehtësim. Inxhinieri-mbikqyrës ka për detyrë ta mbikqyr dhe evaluojë zbatimin e masave të propozuara në kuadër të Planit për mbikqyrje dhe t'i informojë investitorët dhe zyrën për projektin (Komuna Bosilovë).

Publiku do të jetë i kyçur në procedurën për vlerësim të ndikimeve gjatë kohës së debateve publike në komunën e Bosilovës. Komentet e bëra do të përfshihen në raportin e debatit publik, i cili do të jetë pjesë e planit. Në atë mënyrë, të gjitha komentet do të jenë në dispozicion të aplikuesve dhe ato do të marrin të gjitha komentet relevante dhe do t'i përfshijnë në përgjigjet dhe vërejtjet në PMMJ-në përfundimtar.

Zbatimi i planit për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet shoqërore do të bëjë të mundur marrjen në kohë të masave të propozuara dhe do të kontribuojë në realizimin e aktiviteteve projektuese pa ndikime domethënëse ndaj mjedisit jetësor.

Plani për lehtësim
Faza e përgaditjes dhe ndërtimit

Aktiviteti	**Ndikimi i pritur ndaj mjedisit jetësor**	**Masat e propzuara për lehtësim**	**Përgjegjësi për zbatimin e masave për lehtësim**	**Periudha për zbatim të masave për lehtësim**	**Shpenzimet që kanë të bëjnë me zbatimin e masave për lehtësim**
